

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ MFPT-Nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, KRU "Hidromorava" - SH.A., në Gjilan shpall:

KONKURS PUBLIK

I. Për plotësimin e vendeve të lira të punës në KRU. "Hidromorava" - SH.A., në Gjilan, për pozitën:

- **Punëtor i pakualifikuar - punëtor fizik në ujësjellës.**

- **Institucioni:** Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Hidromorava" - Sh.A.
- **Numri i kryesve:** 5 (pesë).
- **Vendi i punës (lokacioni):** Gjilan.
- **Titulli i mbikëqyrësit:** Menaxheri i Divizionit për Mirëmbajtjen e Rrjetit të Ujësjiellësit.
- **Kohëzgjatja e kontratës së punës:** Me kohë të caktuar (me periudhë provuese prej 6 (gjashtë) muaj).
- **Paga bazë:** 528.00€ (bruto)

II. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta

II.I. Kushtet e përgjithshme:

- **Përgatitja profesionale/shkollore:** Shkolla fillore.
- **Përvoja e punës:** E preferueshme.

II.II. Kushtet e veçanta:

- Të ketë aftësi të mira shëndetësore dhe fizike në kryerjen e detyrave të punëtorit fizik;
- Të mos jetë nën hetime apo të ketë qenë i dënuar për ndonjë vepër penale;
- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës.

III. Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Punon në mihjen e kanaleve dhe pastrimin e tyre gjatë eliminimit të defekteve;
- Punon në ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve të ndryshme;
- Bën pastrimin e objekteve, kanaleve dhe pjesëve tjera;
- I zbaton masat e mbrojtjes në punë dhe masave higjieno teknike;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së epërorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj i raporton dhe i përgjigjet Menaxherit të Divizionit për Mirëmbajtjen e Rrjetit të Ujësjiellësit.



Kompania Rajonale e Ujësjetës
"Hidromorava" SH.A
Regionalna Kompanija za Vodovod
"Hidromorava" D.D
Regional Company for Water
"Hidromorava" J.S.C
Gjilan

Çdo kandidat(aplikues) për pozitën e lartëkur duhet t'i kompletoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm si vijon:

- Aplikacionin e punësimit të plotësuar (e gjeni në uebfaqe të kompanisë);
- Dëshmi të kualifikimit shkollor (original ose të noterizuar);
- Dokumentin e identifikimit (kopje të letërnjoftimit, pasaportës);
- Cv (Jetëpëshkrimi);
- Çertifikatën se aplikuesi nuk është nën hetime dhe nuk është i dënuar për ndonjë vepër penale (vërtetimi lëshohet nga Gjykata);

Certifikatën mjekësore(për shkak të minimizimit të shpenzimeve të kandidatëve pjesëmarrës në konkurs, në fund të procedurës rekrutuese, e njehta do të kërkohet vetëm nga kandidatët e suksesshëm, para se të bëhet nënshkrimi i kontratës së punës).

Aplikimi bëhet online përmes e-mailit zyrtar: puna@kru-hidromorava.com, ku bashkangjiten dokumentet e kërkuara sipas konkursit.

Konkursi publikohet përmes uebfaqes zyrtare të kompanisë KRU. "Hidromorava" - SH.A., Gjilan, <https://kru-hidromorava.com/konkurse>, ku mund të shkarkohet aplikacioni për punësim.

Konkursi do të jetë i hapur për aplikim 15 ditë nga dita e shpalljes publike të konkursit, nga data **11.07.2025 deri më 25.07.2025.**

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse aplikacionet e pakompletuara dhe joadekuate do të refuzohen.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

Intervista - deri në 70 (shtatëdhjetë) pikë;

Jetëpëshkrimi (CV) - deri në 30 (tridhjetë) pikë.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

Intervista me gojë brenda 20 ditëve pas mbylljes së konkursit;

Rezultatet përfundimtare brenda 10 ditëve pas përfundimit të procesit të intervistave.

Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet e konkursit ftohen për testin me shkrim, si dhe njoftohen për vendin, datën dhe kohën e mbajtjes së testit me shkrim.



KRU. "Hidromorava" - SH.A.